



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____._____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje mobileri për Kopshtin Nr.3, Bashkia Kurbin”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
39142000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,916,366 (dy milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 58,327 (pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndrshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndrshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures eshte ”Procedurë e hapur e thjeshtuar”, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% te vlerës se përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar.....”*;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”*.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument qe verteton se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per vitin 2024 (sipas QKB) sipas percaktimeve ne ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore ”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 3 (tre) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, e vertetuar kjo me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për të paktën muajn e fundit të deklaruar.
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, për të paktën muajn e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Është kërkuar që OE të ketë të paktën 3 punonjës referuar vlerës së objektit si dhe mallrave që do furnizojë. Gjithashtu AK ka kërkuar që mallrat do transportohen nga vetë OE pjesëmarrës si dhe OE pjesëmarrës duhet të marrë përsipër dhe të garantojë: riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe transportit. Pra është e nevojshme që OE pjesëmarrës të ketë të paktën 3 punonjës (te cilet do bëjnë transportin e mallrave, riparimin për shkak defektesh etj).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti mallrash mbi 1.5 ton, i cili do të shërbejë për të bërë të mundur levrimin e mallrave (material dekorativ) në ambientet e AK, në pronësi të tij ose të marra me qera.

Për mjetin në pronësi të paraqiten:

- Certifikata e pronesisë/ leje e qarkullimit
- Kontrolli teknik SGS (i vlefshëm)
- Taksat e mjetit të paguara (të vlefshme)
- Siguracioni (i vlefshëm).

Për mjetin e marrë me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ofertuesi duhet ta shoqërojë me:

- Kontraten e Qerasë,
- Certifikaten e pronesisë/ lejen e qarkullimit,
- Kontrolli teknik SGS (i vlefshëm)
- Siguracioni, (i vlefshëm).
- Taksat e mjetit të paguara (të vlefshme).

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjeti për të përmbushur kontratën, i nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu sqarohet se mjeti është i domosdoshëm pasi nevojitet për të mundur levrimin e mallrava pranë Autoritetit Kontraktor.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurimet, është tepër e rëndësishme që operatori ekonomik të jete i certifikuar për cilësinë. të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Kjo certifikate lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.4.2 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie të mallrave që kërkohen të prokurohen, nëpërmjet së cilës duhet të marrë përsipër dhe të garantojë: riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe transportit, për një periudhë 1 vjecare nga koha e marrjes në dorëzim të artikujve nga autoriteti kontraktor.
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, nga nenshkrimi i kontrates sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.
- c) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate ku te cilesoje se mallrat e ofruara prej Tij, jane te reja dhe jo te rikonstruata.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet te nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kerkesave te AK. Deklaratat e mësipërme janë kërkuar pasi janë të nevojshme për zbatimin e kontratës me sukses dhe cilësi.

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Në rast kur OE nuk është prodhues ai duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkëpunimi nga një Distributor i Autorizuar për produktet objekt kontrate. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi apo Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo kontraktuesit (Distributor i Autorizuar) si: emer, numer nipti, telefon/fax, e-mail/website.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri i vendosur për paraqitjen e Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkëpunimi është kërkuar për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues me prodhuesin. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike te kërkuara per cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë zbatimit te kontrates.

Shënim: Ne zbatim te pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si*

dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.....etj. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.....”, **sjellim ne vemendje se:**

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t'i dergojë kerkese ne rruge elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit te kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese/mbështetëse për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do te jete kusht s'kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.







II. Argumentimi i specifikimeve teknike:





Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **sipas shkresës Nr.4959 Prot, date 14.10.2024** (e cila eshte bashkëlidhur dosjes).

Përllogaritja e fondit limit është bërë, referuar shkresën Nr.4959 Prot, date 14.10.2024.

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

OBJEKTI: “Blerje mobileri për Kopshtin Nr.3, Bashkia Kurbin”.

Nr	Emertimi	Specifikime	Foto Ilustruese
1	Tavoline ngrenie buke	Permasat(130x60x55)cm.Me kater kembe mbeshetese.Materiali te jete Mdf dhe kembet druri.Siperfaqja siper e lyer me ngjyra te ndryshme.	
2	Rafte kepucesh Etazher	Permasat(200x60cm me ndarje ne mes 30x30 cm dhe me 2 kate .lartesia nga toka 10 cm.Me kater kembe mbeshetese.Materiali te jete Mdf dhe kembet druri.Siperfaqja siper e lyer me ngjyra te ndryshme.	
3	Tavoline rrethore per lodra	Permasa diametri 70cm lartesia nga toka 56 cm me tre kembe,Materiali te jete Mdf dhe kembet druri.Te jete prodhuar me material druri i gjithe skeleti dhe bazamenti ,ndersa syprina te jete material endief ose druri.Permasat e syprines te jene duke filluar nga perimetri i cili do jete Ø 70 cm,lartesia nga toka 56 cm.Ngjyra natyrale.	
4	Tavoline forme trapezi	Permasat (120x60x60cm.lartesia e kembeve nga toka 55 cm.Me kater kembe mbeshetese.Materiali te jete Mdf dhe kembet druri.Siperfaqja siper e lyer me ngjyra te ndryshme.	
5	Rafte lodrash te hapura	Te jene te prodhuara me material prej druri ose endiefi, te jene te ndara me kate dhe me ndarje brenda kateve me hapësira per vendosjen e kukullave dhe lodrave .Dimensionet 120cm gjeresia*90 lartesia me trashesi 40 cm,secili kat..te jete me tre ndarje horizontale kati poshtem nga 40 cm secila ndarje dhe dy ndarje kati lart ne menyre te barabarte me nga 60 cm.Ngjyra te jete blu ,roze,ose e bardhe.Lartesia e kembeve nga toka /rrotullave te jete 10 cm.	
6	Rafte lodrash Etazher	Te jene te prodhuara me material prej druri ose endiefi, te jene te ndara me kate dhe me ndarje brenda kateve me hapësira per vendosjen e kukullave dhe lodrave .Dimensionet 120cm gjeresia*100 lartesia me trashesi 30 cm.te jete me tre ndarje horizontale dhe 2 ndarje vertikale.Ngjyra te jete	

		blu ,roze,ose e bardhe.	
7	Varese rrobash per femije	Permasat te jene gjatesia 200 cmx gjeresia 10 cm me vendosjen e vareses metalike cdo 15 cm si ne foto.	
8	Tabela magnetike white	Tabele magnetike white e cila mund te shkruhet dhe fshihet me permasa (180cmx100 cm)	
9	Rafte per zyre	Te jene te prodhuara prej druri ose me material endiefi me ngjyre natyrale ose te lyera.Dimensionet te jene lartesia 2 meter *180 cm meter gjeresi e ndare ne 2 kate dhe pjesa poshte me 2 rafte dhe pjesa lart me 3 kate te hapura.Trashesia te jete 50 cm.	
10	Tavoline per femije me aftesi ndryshe	Permasat (200x120x70cm)Te jete me strukture druri dhe me syprine druri ose endiefi.Ngjyra te jete roze dhe blu.te jete me 1 syrtar normal.me hapesire poshte.Dimensionet 200 cm gjatesi *120 cm gjeresi dhe lartesia nga toka 75 cm. referoju fotos per tav klasa burimore.	
11	Lodra per femije,argetuese 1-3 vjec	Lodra te ndyshme per femije te moshes 1deri ne 3 vjec ,te jene te paketuara dhe ambalazhuara me permasat mbi 50 cmx30 cm.	
12	Lodra per femije,argetuese 3-6 vjec	Lodra te ndyshme per femije te moshes 3 deri ne 6 vjec ,te jene te paketuara dhe ambalazhuara me permasat mbi 50 cmx30 cm.	
13	Lodra zhvilluese	Lodra te ndyshme per femije te moshes 1deri ne 3 vjec ,te jene te paketuara dhe ambalazhuara me permasat mbi 60 cmx40 cm.	
14	Lodra Mesimore fletore	Fletore dhe libra te ndryshem qe kane tematika mesimore per femijet parashkollore,si fletore te modeluara per shkrim dhe numera te shoqeruara me figura. Fletore ,lapsa ,ngjyra set per secilin.	
15	Lodra pazell formuese	Lodra te ndyshme per femije te moshes 3 deri ne 6 vjec ,te jene te paketuara dhe ambalazhuara me permasat te ndryshme 50 cm x 30 cm e lart.	

16	Dollap per sanitare	Te jene te prodhuara prej druri ose me material endiefi me ngjyre natyrale ose te lyera.Dimensionet te jene lartesia 2 meter *3 meter gjeresi e ndare ne 2kate dhe pjesa poshte me 4 rafte.Trashesia te jete 60 cm.	
17	Karrige per femije (32x32x30x32/60cm)	Permasat (32x32x30x32/60cm)Te jene te punuara me material druri e gjithë skeleti dhe mbeshtetesja.Me kater kembe dhe me ulje tapicerie prej sfunxheri dhe lecke te bute.Dimensionet Lartesia nga toka 32 cm,ulesja 32 cm*30cm lartesia e shpines 60 cm.Siperfaqja siper e lyer me ngjyra te ndryshme.	
18	Tavoline mesuesi (120x60x76cm)	Permasat (120x60x76cm)Te jete me strukture druri dhe me syprine druri ose endiefi.Ngjyra te jete natyrale.te jete me 1 syrtar normal.me hapesine poshte dhe vendin e vendosjen se kompjuterit.Dimensionet 120 cm gjatesi *60 cm gjeresi dhe lartesia nga toka 75 cm.	
19	Karrige per mesues me tapiceri (510x450x780mm)	Permasat (510x450x780mm)Te jene material prej druri ose karrike statike me metal dhe tapiceri.Permasat lartesia 47 cm gjeresia 40 cm*53 cm.Ngjyra natyrale.	

Shenim: Nëse mallrat nuk janë sipas specifikimeve të mesiperme Komisioni nuk do i marrë në dorëzim.

Afatet e lëvrimit: Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. Pjeter Bushi Kryetar (Përsoni përgjegjës)
2. Rudolf Toma Anëtar
3. Aurora Buna Anëtare